

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përberë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku kryetari i kolegjit, Ferit Osmani dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Hysni Ismaili, në çështjen penale kundër të akuzuarve B.B. dhe S.S., i akuzuari i parë nga Gjilani, për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë në bashkëkryerje, nga neni 253 par. 1 nënpar. 1.1 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe i akuzuari i dytë, nga komuna e Vitisë për shkak të veprës penale Pranim i mallrave të vjedhura, nga neni 272 par 2 të KPK-ës, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.626/2007, datë 07.12.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur, më 27.02.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me rastin e ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, e sipas detyrës zyrtare ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.626/2007, datë 07.12.2016, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës ndaj të akuzuarit B.B. përkitazi për veprën penale Vjedhje e rëndë në bashkëkryerje, nga neni 253 par. 1 nënpar. 1.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, për të cilën është shpallur fajtorë, e refuzon akuzën në kuptim të nenit 363 par. 1 nën par. 1.3 të KPPK-së, lidhur me nenin 91 par. 6 të KPK-së, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

II. Ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore është jo lëndore.

III. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës.

IV. Lidhur me kërkesën pasurore- juridike të palës së dëmtuar, aktgjykimi i ankimuar ngel i pandryshuar.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktgjykimin P.nr.626/2007, datë 07.12.2016, të akuzuarin B.B., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë në bashkëkryerje, nga neni 253 par. 1 nën par. 1.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, për të cilat e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, të cilin dënim i akuzuari nuk do ta vuaj, nëse në afatin prej 2 (dy) viteve, pasi aktgjykimi të bëhet plotëfuqishëm, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale. Është obliguar

i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 40 €, në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shpenzimet e tjera të procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, në afat prej 15 ditësh, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Pala e dëmtuar Xh.S. nga Gjilani, për realizimin e kërkesën pasurore-juridike, është udhëzuar në kontest civil.

Me aktgjykimin e lartcekur ndaj të akuzuarit S.S. për shkak të veprës penale Pranim i mallrave të vjedhura, nga neni 272 par 2 të KPK-ës në kuptim të nenit 363 par 1 pika 1.3 të KPP është refuzuar akuza për shkak të parashkrimit absolut të veprës penale. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, për shkak të vendimit lidhur me sanksionet penale nga neni 383 par. 1 nën par. 1.4 lidhur me nenin 387 par. 1 të KPRK-së, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj, ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i lartë dhe me burg efektiv.

Prokurori i Apelit me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr.1523/16, datës 12.12.2016, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarës të shpallet si jo lëndore, ndërsa sipas detyrës zyrtare aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të refuzohet aktakuza për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitat e nenit 394 të KPPK-së, gjeti se:

Me rastin e ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, aktgjykimi i shkallës së parë detyrimisht duhet ndryshuar sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Duke shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në pjesën për të cilën është ushtruar ankesa, sipas detyrës zyrtare, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së, përkitazi me vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret e drejta në ndjekje penale është parashkruar.

Nga shkresat e lëndës del se i akuzuari B.B., është shpallur fajtorë për veprën penale Vjedhje e rëndë në bashkëkryerje, nga neni 253 par. 1 nënpar. 1.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, (i cili ishte në fuqi gjatë kohës kur është kryer vepra penale), për të cilat parashihet dënimi me burgim prej 6 (gjashtë) muaj, deri në 5 (pesë) vite. Sipas dispozitës së nenit 90 par.1 pika 4 të KPK-së, për vepër penale të dënueshme me më shumë se 3 (tri) vite burgim, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 5 (pesë) vite, nga koha e kryerjes së veprës penale (parashkrimi relativ), ndërsa sipas dispozitës së nenit 91 par. 6 të KPK-së, ndjekja penale ndalohe në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale).

Nga shkresat e lëndës, rezulton se vepra penale nga i akuzuari është kryer më datë 14.06.2006, kurse afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon të rrjedhë nga data kur është kryer

vepra penale. Në rastin konkret duke pasur parasysh se nga koha e kryerjes së veprës penale, ka kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, prej kohës së kryerjes së veprës penale e deri në arritjen e lëndës me ankesë në Gjykatën e Apelit me datën 25.01.2017,(gjyqtarit të çështjes i është dorëzuar me 09.02.2017), kanë kaluar me shumë se 10 (dhjetë) vite, nga këto arsye aktgjykimi i kundërshtuar është dashtë të ndryshohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për ç'arsye ankesa e prokurorit është jo lëndore. Shpenzimet e procedurës penale konform dispozitës së nenit 454 par. 1 të KPPK-së bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Kurse ndaj të akuzuarit S.S., për shkak të veprës penale Pranim i mallrave të vjedhura, nga neni 272 par. 2 të KPPK-së, është refuzuar akuza për shkak se Prokurori i shtetit është tërhequr nga aktakuza, për shkak të parashkrimit absolut dhe nga këto arsye aktgjykimi përkitazi me këtë të akuzuar ngel i paprekur.

Nga sa u tha më lartë, konform dispozitës së nenit 403 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.87/2017, datë 27.02.2017

Bashkëpunëtori profesional,
Hysni Ismaili

Anëtarët e kolegjit:
Ferit Osmani
Biljana Rexhiq

Kryetari i kolegjit
Hashim Çollaku